



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2961/11 prot.

Datë 06.02.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 144/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 35/2024, datë 10.01.2024 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “*Blerje Pajisje Elektronike*” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me NIPT: L82428011G  
*Adresa: Njësia Administrative nr. 10, rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë  
*Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

## I

### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 10.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.35/2024, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.*
- 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 1539 prot., datë 30.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2961/8 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 35/2024, datë 10.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1 Me shkresën nr. 1539 prot., datë 30.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2961/8 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 35/2024, datë 10.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “*Blerje Pajisje Elektronike*” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit në përputhje me vendimin nr. 35/2024, datë 10.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, por nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka zbatuar vendimin Nr. 35/2024, datë 10.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, por nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88523-11-21-2023, me objekt “*Blerje Pajisje Elektronike*” me fond limit 5.790.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

